



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. _____ Prot.
____/____/2020

Tiranë, _____ më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Data: 11/06/2020

Nga: Autoriteti Kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Tiranë

Për: "Akademia Shëndetit Publik" sh.p.k. me Nr. NIPTI L32402038K

Adresa: Rruga "Tre Vëllezërit Kondi", Nr. 6 /1, Tiranë

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim - Shërbime, me mjete elektronike.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Dezinsektim, dezinfektim, deratizim ambientesh" - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme X çmimi më i ulët

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-58264-05-15-2020

Fondi limit për njësi: 40 lekë (dyzetë) lekë pa TVSH për m².

Vlera e Marrëveshjes Kuadër është vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj: 1,748,672 (një milion e shtatëqind e dyzetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Financim nga Bashkia Tiranë në mbështetje të Vendimit Nr.157 datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak të Tiranës për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020".

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 29.05.2020

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---|--------------------------------------|
| 1. “HOREAL Expo Group” sh.p.k.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | L52313007M
<i>numri i NIPT-it</i> |
|---|--------------------------------------|

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 30 (tridhjetë) lekë pa TVSH për m².

- | | |
|---|--------------------------------------|
| 2. “Akademia Shëndetit Publik” sh.p.k.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | L32402038K
<i>numri i NIPT-it</i> |
|---|--------------------------------------|

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 29 (njëzetë e nëntë) lekë pa TVSH për m².
Është skualifikuar operatori ekonomik i mëposhtëm:

- | | |
|---|--------------------------------------|
| 1. “HOREAL Expo Group” sh.p.k.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | L52313007M
<i>numri i NIPT-it</i> |
|---|--------------------------------------|

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “HOREAL Expo Group” sh.p.k., është konstatuar se:

- Operatori ekonomik sipas procesverbalit Nr.1011/1 Prot., datë 29.05.2020 të firmosur dhe nga administratori i shoqërisë, tërhoqi mostrat për pajisjet që kryejnë shërbimin me pretendimin se ato i duhen për punën që do të kryejë, duke mos i lënë mundësi Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të bëjë kontrollin e mostrave me imtësi si dhe verifikimin e tyre me specifikimet teknike të paraqitura në skedat teknike të kërkuara në Dokumentat Standarde të Tenderit.

Tërheqja e mostrave është bërë në kundërshtim me pikën 5 të udhëzimit Nr.2, datë 02.05.2019 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” e cila citon se: “Mostrat e paraqitura nga ofertuesit duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në administrim dhe ruajtje të autoritetit kontraktor. Mostrat e administruara do t’i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës...”.

- Për dezinfektantin “Virocid” nuk ka asnjë të dhënë për prodhuesin apo distributorin e autorizuar për tregëtim. Certifikata e analizës nuk ka asnjë informacion për përmbajtjen e këtij produkti.
- Nuk janë paraqitur MSDS (materiali me të dhënat e sigurisë) për asnjë nga dezinfektantët, insekticidet dhe rodenticidet e kërkuara.
- Mungon katalogu për pajisjen e nebulizatorit ULV dhe fogging grimca për ambientet

e brendshme e cila duhet të jetë me bateri.

- Nuk janë paraqitur deklaratat doganore, faturat e blerjes apo kontratat e qirasë për pajisjet që do të përdoren për kryerjen e shërbimit. Faturat e dorëzuara nuk përputhen me pajisjet e kërkuara për shërbimin që do të kryhet.
- Janë dorëzuar dy kontrata pune me pozicionin drejtues teknik për dy punonjës të ndryshëm. Janë kërkuar certifikata dhe / ose licenca për 3 (tre) teknik shërbimi DDD dhe 6 (gjashtë) aplikues të lëndëve DDD. Janë dorëzuar certifikata pjesëmarrjesh në workshope për vetëm 7 (shtatë) punonjës. Për 1 (një) punonjës është dorëzuar vetëm kontrata e punës. Operatori ekonomik nuk ka saktësuar personelin e kërkuar i cili do të realizojë shërbimin e kërkuar.
- Nuk është dorëzuar fatura që vërteton se ka gjendje antidota.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

- | | |
|--|------------------------|
| 1. “Akademia Shëndetit Publik” sh.p.k. | L32402038K |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera 29 (njëzetë e nëntë) lekë pa TVSH për m² dhe vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër për 12 muaj do të jetë 1,748,672 (një milion e shtatëqind e dyzetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Rr. “Abdi Toptani” Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen. Në momentin e paraqitjes duhet të sillni të gjithë dokumentacionin e paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.06.2020

Ankesa: Jo

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rudina Hoxha